



Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 pika d) lidhur me nenet 28, 29 dhe nenin 40 paragrafi 2 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), neneve 14 dhe 15 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.7/2011), nenit 46 dhe nenit 47 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës, në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 28.02.2024, merr:

### **VENDIM Nr.08/2024/KG**

## **PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL SHUMËFUNKSIONAL**

### **Neni 1**

Miratohet Marrëveshja kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional me numër protokollit 14-024/01-233042-23 të datës 15.12.2023, e lidhur ndërmjet 6 komunave, përkatësisht: Kryeqytetit të Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit.

### **Neni 2**

Marrëveshja sipas nenit 1 të këtij Vendimi është në juridiksionin vetanak të komunave përkatëse dhe synon t'i bashkërendojë aktivitetet ndërkomunale ndërmjet kryeqytetit dhe komunave fqinje në fusha të ndryshme me interes të përgjithshëm me qëllim të krijimit të përfitimeve për mirëqenien e qytetarëve në sfera të ndryshme të jetës.

### **Neni 3**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional me numër protokollit 14-024/01-233042-23 të datës 15.12.2023, të nënshkruar nga kryetarët e komunave në fjalë si përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel lokal, të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjës: Kryetarja e Komunës së Graçanicës dhe drejtoritë komunale, në varësi të fushëveprimit të tyre.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi nga dita e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit



*[Handwritten signature]*  
Blaz Dimitrijević